



REPUBLIKA E SH QIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
VLORE

Nr. 73 Vendimi  
Datë 16.02.2012

665/73 Akti  
16.02.2012

V E N D I M  
"NE EMER TE REPUBLIKES"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e përbërë prej:

VJOLA CANAJ GJYQTARE

Asistuar nga sekretare seance Anila Rista, sot me datë 16.02.2012 përfundoi në seancë gjyqësore  
shqyrtimin e kërkesës penale që i përket

**Kërkues:** [redacted] i biri i [redacted] dhe [redacted] dtl 02.08.1953, lindur dhe  
banues në [redacted] Vlorë, mbrojtur nga av. [redacted] anëtar i  
Dhomës së Avokatisë Vlorë

**Objekti:** Kërkohet kthimi i sendeve të sekuestruara

**Baza ligjore:** Neni 480 i Kodit të Procedurës Penale

**Me pjesëmarrjen e:** Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë përfaqësuar nga prokurori  
[redacted]

Në diskutimin përfundimtar palët pretenduan:

Kërkuesi Rustom Sherifaj dhe mbrojtësi i tij i zgjedhur, av. [redacted]

Pranimin e kërkesës, kthimin kërkuesit të dokumentacionit të automjetit në pronësi të tij.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë:

Pranimin e kërkesës

Gjykata, si shqyrtol provat e paraqitura dhe dëgjoji pretendimet përfundimtare të palëve

## VEREN

Se përpara kësaj gjykate u paraqit kërkesa e kërkuetit [redacted] me objekt: "Kërkohej kthimi i sendeve të sekuestruara".

Sipas kërkuetit [redacted] ai është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë për veprën penale "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor" parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal por gjykata në vendimin e dënimit nuk është shprehur për provat materiale të sekuestruara kërkuetit në fazën e hetimeve materiale. Kërkueti pretendoi se duke qenë se çështja në ngarkim të tij është në fazën e ekzekutimit ai i kërkon Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për t'iu kthyer automjeti i sekuestruar si dhe dokumentacioni i tij. Nga ana tjetër prokurori u shpreh për pranimin e kërkeses së kërkuetit [redacted].

Gjykata në analizë të provave të paraqitura nga pala kërkuete vlerëson se gjatë shqyrtimit gjyqësor kësaj kërkesë rezultoi e provuar se me procesverbalin e datës 07.09.2008 mbajtur nga agjenti i policisë [redacted] është dokumentuar sekuestrimi i provave materiale të mëposhtme në lidhje me aksident të ndodhur në fshat [redacted] mjeti tip "ZUK" me targa [redacted] si dhe dokumentet e këtij mjeti - leje qarkullimi, kolaudim, siguracion, taksë regjistrimi, taksë qarkullimi, leje drejtimi me [redacted].

Çështja i është përcjellë për gjykim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe kjo e fundit me vendimin nr 89 datë 05.03.2009 ka vendosur të deklarojë fajtor të pandehurin [redacted] për kryerjen e veprës penale të "Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor" dhe në bazë të nenit 290/1 të Kodit Penal e ka dënuar atë me 1 (një) vit burgim. Në dispozitivin e vendimit, gjykata nuk është shprehur për prova materiale sekuestruara dhe ky vendim ka marrë formë të prerë me vendimin nr 117 datë 09.03.2011 të Gjykatës së Rrethit Vlorë me të cilin është vendosur mospranimi i ankimit.

Çështja në ngarkim të shtetasit [redacted] është aktualisht në fazën e ekzekutimit pasi vendimi me të cilin ai është dënuar, ka marrë formë të prerë.

Neni 480 i K.Pr.Penale shprehet: "Në fazën e ekzekutimit gjykata është kompetente të vendosë për shuarjen e veprës penale pas dënimit, për shuarjen e dënimit, për dënimet plotësuese, për konfiskimin ose anulimin e sendeve të sekuestruara si dhe për çdo rast të parashikuar në ligj."

Në këto kushte, gjykata është kompetente të shprehet në lidhje me sendet që i janë sekuestruar kërkuetit e në lidhje me këto sende të sekuestruara gjen zbatim neni 190 i Kodit të Procedurës Penale sipas të cilit:

"Në vendimin përfundimtar ose me atë të pushimit të çështjes gjykata ose prokurori caktojnë se cilin duhet bërë me provat materiale duke urdhëruar:

- .....
- .....
- .....

ç) sendet e tjera u kthehen personave që u takojnë dhe kur ka konflikt për pronësinë e tyre, ruhen gjersa ai të zgjidhet nga gjykata.

Në këto kushte, gjykata vlerëson se shtetasi [redacted] i duhet kthyer mjeti mjeti tip "ZUK" me targa [redacted] si dhe dokumentet e këtij mjeti - leje qarkullimi, kolaudim, siguracion, taksë regjistrimi,

77

leje drejtimi me nr [redacted] sa kohë që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë në vendimin [redacted] nuk është shprehur në lidhje me to. Mbajja e këtyre sendeve nuk i shërben me procedurën penale dhe kërkesat e tyre shtetasit të cilit i janë sekuestruar nuk bie në kundërshtim me vendimin e gjykatës që është marrë në themel dhe as me nenin 190 të Kodit të Procedurës Penale.

### PER KETO ARSYE


Gjykata, bazuar në nenin 190 dhe 480 të K.Pr.Penale

### VENDOSI

Pranimin e kërkesës së kërkuarit [redacted]  
Kërkimin e kërkuarit [redacted] të sendeve të mëposhteme:  
mjeti tip "ZUK" me targë [redacted] si dhe dokumentet e këtij mjeti – leje qarkullimi, kolaudim, siguracion, taksë regjistrimi, taksë qarkullimi, leje drejtimi me [redacted]  
shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuarit.  
Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 10 ditëve nga e nesërmeja e shpalljes.

Shpallet në Vlorë, sot më datë 16.02.2012

SEKRETARE  
ANILA RISTA



GJYQTARE  
VJOLA ÇANAJ



176

Shpenzime gjyqësore  
Shpenzime kancelerike 500 lekë  
Gjithsej 500 lekë

Sekretare  
Anila Rista



27 02 2

